



*Në fillim të vitit 1990, disa bashki Finlandeze filluan të investonin në sistemet e ngrohjes me biomasë për ndërtesat e bashkive, të tilla si shkollat dhe shtëpitë e pleqërisë (prodhimi < 1MW). Në të njëjtën kohë fermerët krijuan një formë të re të sipërmarrjes rurale, të ashtë-quajturën “sipërmarrja e ngrohjes”.*

Kjo do të thotë që ata furnizonin klientët me ngrohtësi të prodhuar nga biomasa e pyjeve. Mënyra e veprimit është e tillë që sipërmarrësi kryesisht mbarë përgjegjësinë për kujdesjen për ngrohjen e ndërtesave të ashkive dhe furnizimin me lëndë të biomasës.

Sipërmarrësit e ngrohjes ose ndërmarrja e ngrohjes është një sipërmarrës i vetëm, një kooperativë, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose një konsorcium, i cili kryen punën dhe mirëmbajtjen në fabrikën e ngrohjes dhe shet ngrohjen. Ndërmarrja e ngrohjes zakonisht funksionon në nivel lokal, dhe lënda kryesore është biomasa drusore. Lëndët vijnë nga pyjet e vetë sipërmarrësit ose nga pronarët e pyjeve lokale ose industria e përpunimit të drurit. Sipërmarrësi i ngrohjes vepron në fabrikën e ngrohjes dhe fiton të ardhura bazuar në sasinë e nxehtësisë së prodhuar.

Bashkitë kanë rolin kryesor në krijimin e ndërmarrjeve të ngrohjes, pasi ato zotërojnë ndërtesa publike, siç janë shkollat dhe shtëpitë e pleqërisë që kanë nevojë për ngrohje. Bashkitë mund t'i blejnë këto shërbime nga sipërmarrësit lokalë. Në këtë mënyrë, paratë e shpenzuara më parë për ngrohje tani qarkullojnë në nivel lokal, duke nxitur jetesën lokale dhe rritur sasinë e të ardhurave të tatueshme në nivel lokal.

Kur zgjedh formën e sipërmarrjes së ngrohjes, faktorët që duhet të merren parasysh përfshijnë madhësinë e ndërtesës që duhet ngrohur dhe investimet e kërkuara. Koncepti më i zakonshëm është ai në të cilin 1-3 sipërmarrës janë përgjegjës për ngrohjen e objekteve lokale. Në raste të tilla, madhësia e centraleve të ngrohjes është zakonisht 50-500 kWth. Sipërmarrësit e ngrohjes janë zakonisht fermerë që mbajnë pyje. Në impiantet e vogla të menaxhuara nga sipërmarrësit e ngrohjes, lënda kryesore është zakonisht druri. Shumica e impiantëve në Finlandë menaxhohen nga një sipërmarrës i vetëm dhe prodhimi tipik i bojlerëve është 75-370 kW.

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans



Ekzistojnë dhe konsorciume sipërmarrëse me 2-4 anëtarë secila. Shumica e impiantëve janë ndërtesa shkollore dhe prodhimi tipik i bojlerit 60–300 kWth. Në këto impiante më shumë se 50% e lëndëve të drurit janë prodhuar nga pyjet e tyre dhe pajisjet private.

Vetëm në një numër të vogël të impianteve, ngrohja është realizuar nga një kompani me përgjegjësi të kufizuar që ka investuar në pajisjet e prokurimit të drurit ose në një kaldajë.

Në kooperativën e ngrohjes, mënyra e operimit është e tillë që pronarët e pyjeve të bashkëpunojnë në prokurimin dhe shpërndarjen e lëndëve djegëse të objektet e konsumatorit. Anëtarët e kooperativës gjithashtu fitojnë të ardhura në formën e interesit të paguar për kapitalin e investuar dhe dividendët e paguar nga kooperativa. Zgjidhja e bashkëpunimit është e përshtatshme kur kemi të bëjmë me ngrohjen e entiteteve më të mëdha se një ndërtesë e vetme, për shembull, impiantet e ngrohjes qendrore.

*Burimi: Sipërmarrja e Ngrohjes me Biomassë në Finlandë—E. Alakangas, VTT.*

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans

